

VENDIM
Nr. 36, datë 3.3.2022

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“LAJTHIZA INVEST” SHA, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “QAMI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 322/3 prot., datë 28.2.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 11, datë 21.1.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, në përroin e Srriqes, Satrave dhe Valës, degë të përroit të Srriqes, i cili ndodhet në anën e majtë të lumit Drin, qarku Kukës.

- ERE, me shkresën nr. 70/2 prot., datë 21.1.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e procedurës dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta (data 4.2.2022), nuk rezultoi të ketë pasur të tilla.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 11/3 prot., datë 2.2.2022, nr. 11/5 prot., datë 17.2.2022, dhe nr. 11/6 prot., datë 25.2.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion dhe informacion, sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a. rezulton se shoqëria ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “f”: plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”: plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”: plotësuar;
- dokumentacioni tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4, gjerat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”: plotësuar;
- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”: plotësuar.
- Me qëllim sqarimin e konstatimeve në lidhje me dokumentacionin që ka të bëjë me dokumentacionin pronës (neni 9, pika 2, germa “g”) dhe studimin e fizibilitetit (neni 9, pika 4.1.4, germa “g”) dhe në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë”, vlerësohet e arsyeshme të zgjatet me 10 ditë pune vendimmarrja e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.p.k., për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 10 (dhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.p.k., për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti